



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 811/5 Prot

Tiranë, më 14.12.2020

**V E N D I M**

Nr.178, datë 14.12.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit të DAP, për skualifikimin e konkurrentes \*\*\*\*\* , nga procedura e konkurrimit për lëvizje paralele, me kod #3270, për pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë Financave dhe Statistikës”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga nëpunësja \*\*\*\*\* , për parregullsi në procedurën e konkurrimit për lëvizje paralele, me kod #3270,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\* , protokolluar me nr.811/1 prot., datë 09.11.2020 është ngritur një pretendim për skualifikim të padrejtë, në procedurën e konkurrimit me kod #3270, “Shpallje për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese”, për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Financave dhe Statistikës”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nga procesi i verifikimit të pretendimit të mësipërm, rezultoi që kandidatja \*\*\*\*\*, në zbatim të të drejtës që i jep pika 4, e nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, përmes portalit *online* të Departamentit të Administratës Publike, në datën 04.11.2020, ka aplikuar për lëvizje paralele, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Financave dhe Statistikës”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, duke ngarkuar në mënyrë elektronike gjithë dokumentacionin e kërkuar në shpalljen për aplikim.

Në vijim, pas aplikimit, në datën 06.11.2020, ankuesja nëpërmjet e-mailit është njoftuar nga ana e njësisë përgjegjëse, se nuk është kualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, për arsye se:

Së pari, pozicioni që ka mbajtur kandidatja në shërbimin civil si “Drejtor Ekonomik”, pranë Bashkisë Durrës, është i kategorisë të nivelit të mesëm drejtues, me nivel të pagës IIb, si rrjedhim gëzon statusin e nëpunësit civil në këtë kategori, ndërkohë që pozicioni për të cilin ka aplikuar në shpalljen me kod #3270, “Drejtor i Drejtorisë Financave dhe Statistikës”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, është i kategorisë së mesme drejtuese, por më nivel page III-a.

Së dyti, sipas kushteve të publikuara në shpalljen për lëvizje paralele për këtë pozicion pune, kërkohet që kandidati të ketë vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”, ndërkohë që vlerësimi i paraqitur nga ankuesja, është vlerësimi i fundit i dhënë nga ana e eprorit, që i përket gjashtë mujorit të parë (janar-qershor) të vitit 2019, ndërsa për 6-mujorin e dytë 2019 nuk ka vlerësim, megjithëse vërtetohet se marrëdhënia në shërbimin civil ka përfunduar në muajin Dhjetor 2019, nëpërmjet dorëheqjes.

Referuar sa më sipër, në lidhje me pikën e parë, kërkuesja ngre pretendimin se, pozicioni që ajo, sipas pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka patur emërtesën “Drejtor Drejtorie”, kategoria e nivelit të mesëm drejtues, njëlloj si pozicioni për të cilin ka aplikuar për konkurrimin me kod #3270, pavarësisht se ndryshon niveli i kategorisë së pagave ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore dhe atyre të qeverisjes vendore.

Për më tepër, kandidatja \*\*\*\*\* përmes faqes zyrtare të njësisë përgjegjëse, përpara aplikimit për pozicionin e shpallur në konkurrim, ka kërkuar paraprakisht pranë DAP interpretim, nëse ndryshimi në kategorinë e pagës nga II-b të cilin zotëronte, në kategorinë III-a i cili kërkohet për pozicionin e shpallur, mund të përbënte pengesë për aplikimin për lëvizjen paralele, dhe nga ana e Departamentit të Administratës Publike përgjigjia ka qenë se mund të aplikonte për lëvizjen paralele.

Në lidhje me vlerësimin e rezultatit në punë të paraqitur, i cili i përket periudhës janar – qershor 2019, ankuesja sqaron se, ky detyrim nuk është përmbushur nga ana e njësisë përgjegjëse dhe eprorit direkt të saj, në Bashkinë Durrës, ku ajo ka qenë më parë në marrëdhënie pune e për këtë arsye i është drejtuar këtyre të fundit për kryerjen e vlerësimit për periudhën në vazhdim, por që ende nuk ka marrë një përgjigje.

Në këto kushte, duke kundërshtuar vendimin për skualifikimin për fazat e mëtejshme të konkurrimit, ankuesja \*\*\*\*\*, i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të ndërhyrë për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në zbatim të kompetencave të ngarkuara nga ligji. Gjithashtu, një kopje të kësaj kërkesë, ankuesja e ka paraqitur përmes e-mailit, edhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

Në vijim, Komisioneri pasi u njoh me parashtrimin e fakteve të mësipërme dhe me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja \*\*\*\*\*, me shkresën nr. 887 prot., datë 19.11.2020, me objekt: *“Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e kërkesës së konkurrentes \*\*\*\*\*, për disa pretendime në lidhje me procedurën e rekrutimit për lëvizje paralele, shpallja nr. #3270”*, kërkoi nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike dhe nga njësia analoge e Bashkisë Durrës, sqarime si dhe praktikën shkresore që disponojnë për këtë rast, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e këtyre të fundit.

Ndërkaq, pas fillimit të procesit të verifikimit të këtij rasti, ankuesja \*\*\*\*\*, me shkresën nr. 811/3 prot., datë 23.11.2020 njofton Komisionerin, se Departamenti i Administratës Publike, pas kërkesës për sqarime bërë me shkresën nr. 887 prot., datë 19.11.2020, ka vijuar komunikimin duke i kërkuar disa sqarime dhe dokumenta shtesë në lidhje me procedurën e konkurrimit me kod #3270. Pas vënies në dispozicion të sqarimeve dhe dokumentacionit të kërkuar, DAP ka rishqyrtuar vendimin e skualifikimit dhe ankuesja është pranuar të marrë pjesë në fazën pasardhëse të konkurrimit. Ky veprim administrativ u verifikua edhe online, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, prej nga rezultoi se deklarimi i kërkuar \*\*\*\*\* ishte i vërtetë.

Konkretisht, Departamenti i Administratës Publike, përmes shpalljes *“Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për lëvizje paralele në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese”* ka njoftuar se konkurrentja \*\*\*\*\*, është kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit për pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë Financave dhe Statistikës”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, kategoria III-a, duke i dhënë fund në këtë mënyrë, mosmarrëveshjes.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimi i ankueses \*\*\*\*\*, për shkelje të kryera dhe lejuara gjatë fazës së kualifikimit në procedurën e konkurrimit me kod #3270,

nga ana njësisë përgjegjëse, është marrë në konsideratë nga kjo e fundit, duke rishikuar vendimin e saj dhe pranuar këtë konkurrenë për pjesëmarrje në fazat e mëtejshme të konkurrimit.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të ankesës nr. 811/1 prot., datë 09.11.2020, të paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*, për skualifikim të padrejtë për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit për lëvizje paralele, shpallur me kod #3270, pasi kërkesa e saj u rivlerësua dhe u pranua të vijojë procedurën e konkurrimit, duke bërë që çështja të mos ketë më objekt, e për këtë arsye ajo të arkivohet.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**